



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:033972
Datë: 04.12.2024
Numri i dokumentit: 06545184

C.nr.164/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Feim Bytyqi, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësve L.B nga Fushë Kosova, A.K nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, Sh.I nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit dhe A.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilët me autorizim i përfaqëson S.M avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, me objekt kontesti kompensimi nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 4,709.64 euro, jashtë seancës, me datë 04.12.2024, bie këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve L.B nga Fushë Kosova, A.K nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, Sh.I nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit dhe A.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit për udhëtim t'ia paguaj shumat si në vijim:
paditëses L.B, për periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datën 21.11.2022, për 324 ditë pune të ja paguajë shumën prej 2,608.20 euro;
paditësit A.K për periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datën 21.11.2022, për 330 ditë pune të ja paguajë shumën prej 1,386.00 euro;
paditësit Sh.I në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës t'ia paguajë 75% të pagës bazë (paga bazë 459.00*75% euro) në shumë prej 344.25 euro.
paditësit A.H në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës t'ia paguajë 75% të pagës bazë (paga bazë 459.00*75% euro) në shumë prej 344.25 euro.

Të gjitha këto në shumë totale 4,682.70 € (katërmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë (29.01.2024), e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 333.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë lidhur me shpërblimin jubilar dhe atë:
paditësit Sh.I, t'ia paguaj shumën prej 13.47 euro,
paditësit A.H, t'ia paguaj shumën prej 13.47 euro, apo në shumë të përgjithshme prej 26.94 €.

A r s y e t i m

Paditësit L.B nga Fushë Kosova, A.K nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, Sh.I nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit dhe A.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, përmes të autorizuarit të tyre av.S.M nga Rahoveci, me datë 29.01.2024 pranë kësaj gjykate kanë

parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën kanë kërkuar kompensimin nga marrëdhënia e punës të përshkruara më për së afërmi si në padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi të paraqitur në gjykatë me datë 21.06.2024, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, me arsyetimin se padia nuk përmban faktet mbi të cilat paditësit e mbështesin bazën e kërkesës së padisë e as provat të cilat do të vërtetojnë të njëjtat faktet, si dhe në parashkrim të kërkesës, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoj në tërësi si të pabazë.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkangjitura padisë dhe përgjigjes në padi të parashtruar nga e paditura, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjithat së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

Gjykata para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestuese, ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së me të cilin është paraparë që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga e paditura, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike se paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në periudhën kohore për të cilën e kanë kërkuar kompensimin e lartcekur.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune si mësimdhënës tek e paditura në SHML “12 Maji”, në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit, SHML “Ukshin Hoti”, në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit. Këtë fakt gjykata e vërtetoi me shiqimin e kontratave të punës; vërtetimeve për ditët e punës, listës së pagave dhe atë:

Për paditësen L.B, në bazë të kontratës së punës me nr. prot. 06/2983 të dt.01.09.2015, u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune të rregullt si mësimdhënës. Në bazë të vërtetimit për ditët e punës, Nr.prot.08/3804/2021, dt.30.11.2022, gjykata vërtetoi faktin se për periudhën nga data 22.01.2021 e deri me datën 21.11.2022, ka gjithsej 324 ditë pune. Në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit Publik “Rahoveci”, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Fushë Kosovë – Ratkoc dhe anasjelltas, është çmimi 11.50 euro në dy drejtime.

Për paditësin A.K, në bazë të kontratës së punës me nr. prot. 258/18 të dt.03.09.2018, u vërtetua se paditësi është në marrëdhënie pune të rregullt si mësimdhënës. Në bazë të vërtetimit për ditët e punës, Nr.prot.207/22, dt.30.11.2022, gjykata vërtetoi faktin se për periudhën nga data 22.01.2021 e deri me datën 21.11.2022, ka gjithsej 330 ditë pune. Në bazë të vërtetimit të lëshuar nga T, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Zatriq - Rahovec dhe anasjelltas, është çmimi 6.00 euro në dy drejtime.

Për paditësin Sh.I, në bazë të kontratës së punës me nr. prot. 469/15 të dt.11.09.2015, u vërtetua se paditësi është në marrëdhënie pune të rregullt si mësimdhënës. Në bazë të vërtetimit të përvojës së punës, Nr.prot.45/22, dt.31.09.2022, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka gjithsej 20 vite të përvojës së punës.

Për paditësen A.H, në bazë të kontratës së punës me nr. prot. 451/15 të dt.01.09.2015, u vërtetua se paditësi është në marrëdhënie pune të rregullt si mësimdhënës. Në bazë të vërtetimit të përvojës së punës, Nr.prot.29/22, dt.30.09.2022, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka gjithsej 20 vite të përvojës së punës.

Faktin se paditësve iu takon kompensimi për licencim dhe atë:

paditësit L.B, për periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datën 21.11.2022, për 324 ditë pune të ja paguajë shumën prej 2,608.20 euro, duke e llogaritur nga 70% e shumës prej 11.50 euro për çdo biletë (70% i 11.50 euro = 8.05 euro).

paditësit A.K për periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datën 21.11.2022, për 330 ditë pune të ja paguajë shumën prej 1,386.00 euro, duke e llogaritur nga 70% e shumës prej 6.00 euro për çdo biletë (70% i 6.00 euro = 4.20 euro).

paditësit Sh.I në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës t'ia paguajë 75% të pagës bazë (paga bazë 459.00*75% euro) në shumë prej 344.25 euro.

paditësit A.H në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës t'ia paguajë 75% të pagës bazë (paga bazë 459.00*75% euro) në shumë prej 344.25 euro.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve për faktin se paditësit Lavdie Berisha dhe A.K në periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tyre të punës kanë prezantuar në 324, dhe 330 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësit kanë qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve Sh.I dhe A.H në lidhje me kompensimin e pagës jubilarë në shumën prej 344.25 euro. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në lidhje me kompensimin e pagës jubilarë duke u bazuar në dispozitat e nenit 35 par.8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 që parashihet se *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë”*. Pra 75% e pagës bazë në shumën prej 459.00 euro i bie që të jetë shuma e përgjithshme prej 344.25 euro. Kjo është vërtetuar nga lista e pagës, ku vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë paditësit të tretë Sh.I, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 344.25 euro e deri në shumën prej 357.72 euro dhe atë për shumën prej 13.47 euro. Paditësit të katërt A.H për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 344.25 euro e deri në shumën prej 357.72 euro dhe atë për shumën prej 13.47 euro, ngase gjykata vlerëson se në rastin konkret paditësit në kërkesëpadi kanë kërkuar që të kompensohen për pagën mujore (476.96 euro) për paditësin Sh.I, të pagës mujore (476.96 euro) të paditësit A.H, ndërsa bazuar sipas listës së pagave të Maj 2021, Sh.I dhe A.H, janë mësimdhënës me pagën bazë 459.00 C, në kodin e pagave A-459/1.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 29.01.2024, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit e Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e tyre e aprovoi pasi që është e bazuar në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Paditësve Sh.I dhe A.H në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës t’ia paguajë 75% të pagës bazë (paga bazë 459.00*75% euro) në shumë prej 344.25 euro.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që paditësit t’ia kompensojë e paditura shumë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 333,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 260,00 euro si dhe për taksën gjyqësore 31,00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.164/2023, më datë 04.12.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Feim Bytyqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.